



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe verifikimin e gjendjes ekonomike të 21 (njëzet e një) përfituesve të banesave sociale në qytetin e Lipjanit, në këtë përbërje:

1. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor-juridik, Kryesues
2. Zyrafete Mavriqi –Bytyqi, Qendra për Punë Sociale, anëtare
3. Besmir Retkoceri, Sektori i Tatimit në Pronë, anëtar

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Të bëjë verifikimin e gjendjes ekonomike të 21 (njëzet e një) përfituesit e banesave sociale të cilët janë përzgjedhur sipas Konkursit publik 1Nr.360-41414 të datës 06.07.2018, konform Vendimit përfundimtar për shpalljen e familjeve përfituese të banesave komunale sipas programit të banimit 1-360-46751 të datës 24.12.2018.
- Të mbajë procesverbal me shkrim për secilën vizitë të realizuar.
- Pas verifikimit të të gjitha banesave do të hartojë Raport me shkrim për Kryetarin e Komunës duke dhënë Rekomandim për secilin/en përfitues/e për mundësinë e vazhdimit ose mosvazhdimit të Kontratës. Komisioni do t'i kryejë detyrat e lartëcekura më së largu brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-18831
Lipjan, 15.06.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,920.00€**, (dhjetë mijë e nëntëqindë e njëzetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-17265 e datës 02.04.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 39 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin mars të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast $39 \times 280 = 10,920.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-17265
Lipjan, më 03.04.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400/01-17947 të datës 04.04.2024 të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500€ (një mijë e pesqindë euro), Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, për të mbështetur financiarisht për realizimin e aktivitetit për shpërndarjen e dhuratave për fëmijë në sheshin "Adem Jashari" në Lipjan në rastin e festës së Bajramit, sipas kërkesës së tyre 1Nr.400/01-17947 të datës 04.04.2024.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024 pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Bashkësisë Islame në nr. 17192000190037882 në NLB Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raportin financiar dhe të njëjtin të dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu me datë 25.12.2024.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet BIK-u dega në Lipjani.

1Nr.400/01-17947

Lipjan, më 05.04.2024.

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetë qeverisje lokale Nr. 03/L-040, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, neni 40 pika 1, neni 41 pika 1,2,3 të Ligjit Nr. 04/L-032 të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës Datë 29 Gusht 2011, neni 5 pika 3.1 dhe pika 3.2 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2017 të MASHT-it për Themelimin e Ekipit për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veqanta, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E EKIPIT PROFESIONAL PËR VLERËSIMIN E FËMIJËVE ME
NEVOJA TË VEQANTA

I Me këtë Vendim themelohet Ekipit Professional për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veqanta në Komunën e Lipjanit, në përbërje :

1. Teuta Berisha - Pedagoge (Koordinatorë e ekipit),
2. Besarta Trolli - Psikologe (anëtare),
3. Jehona Sopa - Psikologe (anëtare),
4. Vlora Shabani - Asistente për nxënësit me nevoja të veqanta (anëtare),
5. Fjolla Ibrahim - Punëtore sociale (anëtare),
6. Kaltrina Hashani - logopede (anëtare),

II Ekipi profesional vlerësues do t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2017 i MASHT-it si dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet vendimi paraprak për themelimin e Ekipit Professional për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veqanta.

Kopja e vendimit i dorëzohet:

1. Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë,
2. Anëtarëve të Komisionit dhe
3. DKA-së (për evidencë).

Nr. 01-112/02-19496
Datë: 18.04.2024

Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e Planit të Veprimit për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024 - 2026, në përbërje si vijon:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës së Lipjanit, Kryesues
2. Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
3. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
4. Hasan Luma, Zyrtar në Drejtoratin për Administratë, anëtar
5. Makfirete Shamolli, Drejtoreshë e QPS-së, anëtare
6. Milazim Miftari, Shef në Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar
7. Pranvera Krasniqi, Zyrtare në Drejtoratin për Kultur, Rini dhe Sport, anëtare
8. Rafete Retkoceri, Zyrtare në Drejtoratin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare
9. Mirjeta Cakolli-Bajqinca, Doktoresh në QKMF-ja Lipjan, anëtare
10. Jetmir Bytyqi, Zyrtar në Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
11. Shqipe Rexhepi, Zyrtare në Drejtoratin për Inspektorat, anëtare
12. Valdete Muji, Zyrtare Ligjore në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtare
13. Laureta Ahmeti, Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtare
14. Fatlum Breznica, Zyrtar në Drejtoratin për Prokurim, anëtar
15. Merita Zeqiri-Magashi, Zyrtare në Drejtoratin për Infrastrukturë, anëtare
16. Shkelqesa Miftari, Zyrtare në Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtare
17. Feime Selmani, Zyrtare në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
18. Vlora Shabani, Psikologe dhe asistente e fëmijëve me nevoja të veçanta në SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan,
19. Afrim Mena, Shoqata HANDIKOS dega në Lipjan, anëtar dhe
20. Fadil Behluli, Shoqata OMPAK dega në Lipjan, anëtar

Neni 2

Detyrat e grupit punues

Grupi punues ka për detyrë hartimin Planit të Veprimit për personat me aftësi të kufizuar në Komunën e Lipjanit 2024 - 2026 në bashkëpunim me shoqatat lokale Handikos dhe Ompakal që veprojnë në Lipjan, hartimi i planit nga grupi punues do të bëhet konformë dispozitave përkatëse ligjore në fuqi. Punët teknike administrative për grupin punues do të kryhen nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Grupit punues.

INr. 1-020/02-60/55
Lipjan, më 20.10.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

